

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-1
A73

FATOS
ARAPI
DREJT
GINDRA
SHKUJSHI
SHKOUME

poema
e
verifica


891.P83 - 1

SH-1
A73

FATOS ARAPI

DREJT QINDRA SHEKUJSHE SHKOJMË

POEMA
E VJERSHA



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

S H Q I P È R I A

Vend trëndafilash janari.
Statuja mermeri në gji. —
Shqipëri.

Historia — shtrat i Prokustit
Të gjymtonin shtatin,
të copëtonin trupin.
Ti prapë e krijoje:
kryet në zemrën e qellit me ré,
këmbët nér harlisje të detit Mesdhé.

Vend trëndafilash janari.
Statuja mermeri në gji. —
Shqipëri.

Partia vjen,
 si ai prindi, që birin ka këtu
 e gjithë natën e natës nuk e mbyll dot synë.
 Nata kalon nëpër dallgë mendimi,
 nëpër kujtime ku ju hyni-dilni:
 zhveshur, pa ngrënë, zbatohur në dëborë.
 Enveri ju prin me mendimet e veta:
 atje ku bini ju — ngrihet liria,
 atje ku bini ju — prapë ngrihetjeta.
 Pastaj shikon Ai, si vetë historia
 përulet, emrat tuaj merr në duar,
 që nér gishtërinjtë djegin — kalamidhe të nxehta.

Partia, si prindi, që birin ka këtu
 e gjithë natën e natës nuk e mbyll dot synë,
 nér mendimet e veta flet me ju:
 — Atdheu i ri ngrihet... po ndodhka këshku:
 vitet shkojnë tutje... e ju vini tëhu.

TELI NDINI

Kam parë Teli Ndinin të vrarë,
me krye mbi dy qeramidhe,
gjunjët kruspull në gjoks.

Kam parë dy duart e mbledhura,
dy gjysma të globit grushte.

Në to gjithë frontet e luftës,
e gjaku i popujve gjithë,
si lum madhështor i nëndheshëm.

Dy duart e mbledhura grushte.
I vogël ky rruzulli ynë!
Liria e proletarëve
vinte atje e qëndronte, —
zog
me trup prej furtune...

X H E L A D I N B E Q I R I

I vdekur që kurrë në sy nuk vë gjumë.
Dyshek pati tokën, jorgan pati gunën,
vëllezër fishekët, — gjithë jetën i pati.

Njeriu bonjak, që nga barku i nënës
doli, si nga barku i urisë së egër.

Dhe erdhë... u shtri... bri shokëve të vet.

I vdekur, që kurrë në sy nuk vë gjumë.
Po ndjeu diku se Shqipëria thërrret,
ngrihet, hap varrin,
merr malet përpjetë.

I vdekur, që kurrë në sy nuk vë gjumë.

KĀSTRIOT MUÇO HIZ

Brenda një emri...
Demonstratat e Shesheve,
mbledhjet ilegale,
çetat partizane,
varret e shokëve,
pritat e maleve.

Brenda një emri...
Brenda një emri...

Dhe lind liria
me rrënje të çuditshme
në një krohdë buke,
mes për mes shpuar
nga plumbi i egër.

...Brenda një emri.

SHYQYRI ALIMERKO ALIMERKO

Po ndodhka që né, njëzetvjeçarët,
lirinë ta shikojmë në sy, ashtu si shikon prindi fëmijën e vet.
Dhe në shikim, në heshtje, t'i flasim njëri-tjetrit:

— Eh, liri! Ishim të mirë ne,
 ishim të ndershëm...

Ne që trimërisë i buzëqeshëm,

si dashurisë së parë. Kur hidra-vdekje,

me njëqind kokë mbi tokë ecte:

kokë milici,

kokë mercenari,

kokë fashisti,

kokë tradhtari, ne jetës i buzëqeshëm,

si dashurisë së parë.

Eh, liri fëmijë! Shihna drejt në sy!

Ne s'kemi pse të kemi turp prej njëri-tjetrit...

Apo jo, liri?

Jeni shtrirë këtu bri njëri-tjetrit.
 Dhe në zemrat tonë, ~~çështja e~~
 si armët e trupit,
 keni lënë vdekjen tuaj.

Si armët e trupit...

...mëdha përbën i detyruar përgjithës
 brenda një qytetit. Në këtë qytet
 gjithashtu gjendej edhe një
 vjeçor që kishte rritur. Në këtë vjeçor
 me rreth 40 vjeç, që nuk
 është krohet mësuar. Në këtë vjeçor
 përcaktoi sëmundjeve, ikuqitëshme, që
 eplumbi i mëdha përbën i zëta.
 Në këtë qytet, që gjithashtu
 ka qytetin e tij, që
 i cili është i
 një vjeçor që
 ikuqitëshme, që
 eplumbi i mëdha përbën i zëta.

MITAD DAUTI

Fonoi moshën e qytetar,

Mos e thuaj kurrë, o toka ime,
mos e thuaj kurrë se gjithçka bëra për ty:
Rininë... Jetën... Gjakun tim...

Toka ime e rënda dhe e lehta,
si një murmurimë diellore.

Tragjike, si një këngë e përgjakur,
bërthamë legjendash e maleve tona.
Ti heroikja gjer në dhembje...

Mos e thuaj kurrë se të dhashë gjithçka pata:
pranverën e njomë të ëndrrave të mia,
dashurinë që s'e jetova dot.

Mos, mos thuaj, o tokë!
Ç'do të ishte trupi yt,
pa trupin tonë përzier në të?

C'do tē ishte gjaku yt, pa gjakun tonë?
Liria jote c'do tē ishte, —
pa këtë vdekjen tonë?

Edhe këtu nën dhé
ndjej plugun tënd që plugon
kostelacionet e qiellit.
Në pëllëmbët e mia ushqej
farën e bukës sate tē re.
Edhe këtu nën dhé
jam një lumë i tërë dritash gëzimi...

Po ti, mos! Mos e thuaj...
Asgjë... asgjë... asgjë... s'kam bërë pér ty.
Dhe po tē duhet që tē ngrihem
njëqind herë tē tjera,
e përsëri tē bie pér lirinë tënde,
pér diellin tënd, pér bukën tënde, prapë asgjë! Asgjë! Asgjë!
s'kam bërë pér ty...

Toka ime e rënda
dhe e lehta, si pesha e diellit.
Heroikja gjer në dhembje.

LEFTER SALLATA

Yllin e kuq mbi beretë,
sazen e vogël në gojë.
Udhët ngrihen pas teje,
gjithë këngën tënde këndoja.

Këndoja lulet në vazo,
buka përbëti tryezë;
fëshfërin dora e foshnjes
në gji të nënës, si gjethë.

Këndoja turnet e natës,
djersa e ballit punëtor;
këndon fjala «shok»
edhe liria jonë.

Këndoja fjalët në vargje
dhe dashuria e rimave;

dy zjarre që ndizen
në pafajësinë e takimeve.

Këndon ditë e 5 Majit
e tëra në sytë e tu;
ti edhe kënga e jote,
sa shëmbëllekeni ju.

Këndon blegërima e deleve
e lulekuqet në arë;
përkunden valëve të deteve
tufë trëndafilash të bardhë.

Këndon kujtimi i shokëve,
vitet që shkojnë e shkojnë;
të gjitha rrugët e ëndrrave,
pas po të vijnë e këndojnë.

Yllin e kuq mbi beretë,
sazen e vogël në gojë...


Këngën që shkelte mbi vdekjen,
jeta nis ta këndoje.

PIRRO PALLA

(tipograf)

(tipograf)

Pranë fjalës Bukë është fjala Liri,
si pranë Partizan qëndron Shqipëri.
Ku është Fashizëm është Vdekje patjetër,
ku është Nazizëm është krim i regjur
Fjalët si shokët kërkojnë njëra-tjetrën:
pranë fjalës Njeri qëndron fjala Jetë,
si pranë fjalës Bli qëndron fjala Maj.
Dhe fjala Fëmijë ka shoqet e saj:
këtu Pafajësi atje Drejtësi,
këtu është Ëndërr, Dashuri është pastaj.
Në luftë shkojnë fjalët, si ti e si unë.
Si ti e si unë, në gojë presin plumbin.
Përgjaken me gjakun e gjithë njerëzisë, —
ku është Proletarë është Komunizëm.



FIQIRI MUKA

(Shegert)

Fati i grisur i një shegerti.

Shorti i verbër i një jetimi.

Kërcënimi i egër i kryemjeshtrit.

Treçerek leku në ditë shpërblimi.

Treçerek leku në ditë djersa.

Treçerek leku dhe gjaku vet.

Për treçerek leku blinte mesjeta
jetën, shegerte

të shekullit XX.

(fëlpcim)

Dhe të mendosh pastaj; çfarë pemë e çuditshme që qenka liria!
Me rrënjet e saj në eshtrat e tua, të këtij e atija.
Mijëra...mijëra...mijëra...
Milionë...milionë...milionë.., për lirinë vdekur,
Nga poli në pol, nga populli në popull, nga shekulli në shekull.
Njerëz, hallé, brenga, luftëra, shpresë, këngë.
Të rënë... të rënë... të rënë...
E të gjithë rrënje, ushqejnë lirinë.
Lirinë.
Njerinë.

FADIL DAUTI

(*këpucar*)

Duart që bënин këpucë fëmijësh,
morën vetë formën e papuçeve të vogla,
të këmbëve të njoma,
që duke u dridhur të pasigurta
hedhin hapin e parë në jetë. —
Hop! E sheh që ecën?

Ashtu...ashtu...ashtu...Mos ki frikë...hop!

Jetë-fëmijë...mbahu! U rrëzove?

Ngreu vetë...vetë...vetë...

Jashtë gjëmon çizmja e rëndë esese.

Jashtë Gebelsi i mban fjalim Gebelsit.

Ti ngreu vetë...

Këmbëzat e vogla shkelin të habitura tokën.

Tokën?, Oh, me se nuk e mbjellin atë.

Nëpër këmbët e tua mbjellin Dahaun.

Lidiçen e Borovën mbjellin.

Ti mos u pengo!

Ja duart e mia, gjurmashka të vogla:

jetë-fëmijë...ec vetë...vetë...vetë...

ZAHO KOKA

Në vendin tim
lindin njëherësh
dhe portokallat,
dhe Vetëtimat. 1)

Në vendin tim.

1) Zaho Koka-me pseudonim Vetëtima .

HYSEN ÇINUA~~KOK~~ZAHOK

Sa herë vdekja ia mbathi me të katra,
«ikë, t'ikim!» ulerinte nëpër fushë të luftës,
përpara këtij burri, që shtrihet këtu...

...ku unë kam parë

blegërimat e qingjave,

lulebeçkat e bardha,

që vijnë e qajnë.

Ijetë-knjipë, i jetë-knjipë!

Nigreu vole, vole, vole!

Tashë gjetme çamja e vendit kose!

Jashtë Gjetës i njësë flakës këshelit,

Të ngrera vole...

Gjetë-knjipë e vogës akletin të luftës së luftës!

Tohet? Oh, më më vole, më vole!

Nëpër këmbët e llaq bregdetin, më vole!

Lidhën e Rrëzave, më vole!

Të mire si pëndur!

Jë dueti e vole, qëndro, qëndro!

gjetë-knjipë, më vole!

SULO DIDI

Pse të mos ketë ndodhur edhe kështu, pse?
A nuk shkeli këndejej Cezari?
Pompej, a nuk shkoi këndejej?
Dhe cili sulltan, i vjetër a i ri,
dalë prej xhunglave të Evropës moderne,
apo prej natës së qullët të Azisë primitive,
nuk këputi, ja, nga ky ulli,
ja, nga kjo degë e ulur gjer afër tokës, —
biskun e njomë që mbajti në dorë?
Gishtérinjt' e Cezarit fëshfërinin gjethe ulliri.
Buzët e Cezarit murmuritnin gjethe ulliri.
Sytë e Cezarit buisnin gjethe ulliri.
Dhe ai shkelte nëpër skenën e ditëve,
ndërsa dora e tij prej kryeaktori,
gjithnjë e gjithnjë këpuste, ja, këtë degë,
Ja, nga ky ulli...
Dhe gjithnjë e gjithnjë ne, njerëz të thjeshtë
të këtij vendi të vogël, që vetë (shikojeni mirë!)
më paska formën e gjethes së ullirit, —

në luftëra të shenjta mbronim lirinë.

Dhe binim...

Dhe shtriheshim...

Në shtresa të tokës e të kohëve

rrënje të përgjakura,

ja, të këtij ulliri...

DADAN DAJLANI¹⁾

Ne po loznim me lodra,
kur koha na vuri në duar një pushkë,
në xhepa ca bomba...
dhe na nisi për luftë.

Ndërsa vetë ajo, ashtu si ndër lodra,
shkurdiste Hitlerin,
zhvidhoste Musolinin. —
I zbërhente të shihte
brenda tyre ç'kishin...

Kjo kohë e popujve.
Heroike,
e madhe...
Si ndonjë fëmijë, pjesëzat e tyre
i merrte nér duar,
edhe i montonte,
edhe i çmontonte,
gjersa neveritej e i braktiste fare...

1) Dadan Dajlani-shok i fëmijnisë.

IKJA E FĒMIJNISË

DADAN DADAN

Në shtrëng të tregu që është
rënje se përfundon
ja, të kryet më.

Nata ikte e kryet kthente pas,
Shihte ditën që vinte:
katër shokë të vrarë
ajo mbante nér duar.

Kishin vrarë Bajramin, kishin vrarë Muminin¹⁾.
Kishin vrarë Hiqmetin, kishin vrarë Hajredinin.

Në oborin e vogël të shtëpisë me kallama,
një këmishë e përgjakur,

mbi një degëz ulliri.

Qielli qe po ai.
Toka qe po ajo.

Heronj të Popullit. Rënë në luftë kundër fashistëve itali-anë në tetor 1942.

Midis qiellet e tokës ikte nata.
Fëmijnia ikte...
 kryet kthyer nga prapa...
Thellë syve të saj — ajo degë ulliri
 lyer me gjakun e shokëve.

Ditë të tjera të zjarra,
para meje shpaloste
 lufta e madhe e popujve.

HIMN JETËS

I dëgjon zërat e dritës?
Shkrepëtin agimi vetë.
Jeta qenka si fëmija, —
jepi dorën që ta ngresh.

Që të vijë jeta me ty,
nëpër diell e furtunë,
mbille në një pikë djerse,
mbille në një kokërr grurë.

Mbille në një gërrm'e shkronjë,
mu në zemër të një fjale,
zërave të lehtë të prillit,
ardhjes së dimrit në male.

Mbille në duart e pleqve,
nëpër buzë të fëmijëve.
Në pikën e gjakut — jetën,
në një thërrmizë drite mbille.

Që të vijëjeta me ty,
si vjen shoku i vërtetë...
Mirë, ahere! Shko drejt saj,
bëju shok jetës ti vetë.

Ndizi diejt! Ndizi qiejt!
Qiell e diell trupi tënd.
Romantikat e përgjakura
kap'e mbërtheji me dhëmbë.

Si kotelet i merr nëna,
i çonë nga një ditë në tjetrën,
mes përleshjeve njerëzore,
ashtu ti rrëmbeje jetën.

Dashurinë rrëmbe dhe ëndrrat.
Rekëtim i kohës s'ndalet,
Edhe vetë në fjalën «vdekje»
mbille e jeta do të ngjallet.

I dëgjon zërat e dritës?
Shkrepëtin agimi vetë.
Jeta qenka si fëmija,
të shikon në sy....
e qesh.

P O E Z I S È

Mbrëmjeve në sofër së bashku bukën e thyenim,
ua jepnim fëmijëve.

E njëri-tjetrin shihnim në sy.

E sytë e njëri-tjetrit kërkonim

nëpër sytë e tyre.

Bisedonim. Qeshnim.

Mendonim. Heshtnim.

Herë-herë shaheshim. Grindeshim.

Ditë të tëra s'flisnim.

Binim në shtrat e njëri-tjetrit i kthenim kurrizin.

Poezi, ti ishe gruaja, nëna.

Dora jote, gjethe e butë hardhie,

lëmonte kryet e fëmijëve.

Dhe u flisje fjalë të ëmbla, të ëmbla...

Të ëmbla ua bëje dhe përrallat dhe ëndrrat.

Unë të thosha: leri iluzionet! Jeta është jetë...
Ndofta nesër, të parën barrikadë lirie,
ata do ta hapin nëpër veten e vet.

Ti më thoshje: po janë fëmijë.
Një këngëz, një nina-nani e duan shumë.
Léri profkat! — thërrisja unë.
Në një nina-nani epokat qanë
apo qeshën?

Brenda një nina-nani ti edhe unë,
mund të lindim, ashti si mundet edhe të vdesim.

Leri profkat! — gërrthisja unë.
Nesër,
ata me gjak të mushkërive të shekullit të tyre,
ndofta vetë perënditë
do të pështyjnë në fytyrë.

Dhe binim në shtrat.
Me duart e mia të zhvishja linjën e trupit.
Ti mbështilleshe në hutimin tënd mjegullor,
të bardhë.

Dhe ahore

Asgjë mbinjerëzore s'kishte tek ti,

asgjë jonjerëzore s'kishte tek unë...

Dhe prapë në frymëmarrjen tënde dhe timen
diçka më e shenjtë se erërat e Olimpit
përkunder.

Rasti

keq, gëzave, fëmijëve, lëllës, frëngjat

me qytetin, durrësi, qytetit, qytetit, qytetit

qytetit, qytetit, qytetit, qytetit, qytetit

R I N I S È

Rini,
e bukura rini,
sykaltra,
trupholla,
përherë e qeshura, rini,
përherë e dashuruara...

Tetori dallëndyshet,
me fishkëllima ererash,
mbi tela telefoni i mblodhi trumba,
të shqetësuara,
të gëzuara.
Mbi cicërima të tyre krahët hapin,
me cicërima të tyre krahët mbushin,
për shtegtime të gjata.
Mbi fishkëllima ererash e tela telefonësh
qëndruan dallëndyshet, si ti qëndrove
përmbi këngën time. —

Rini,
profil i hollë,
aromë hijesh e linjash të brishtme.

Mejtimi im ra përmbi ty,
u çlodh në gjelbërimin e pérhershëm tënd.
Gëzimi im hyri tek ty,
korije fëshfërítëse e èndrrave,
që sapo çelin;
e dashurive, që sapo dashurohen
e me duar që dridhen
për herë të parë prekin
trupin e njëra-tjetrës.

Rini,
kënga rend nëpër tokë ditën, natën,
me ty fluturon hekurudhave,
ngjitet tarracave,
qiellin kënga sulmon, përpin retë...
Planetët (të gjallë a të vdekur) luajnë vendit,
i hapin udhë.
Kënga tejepërtej përshkon horizontet:
«Bota është jotja».

Thirrje erërash, shirash,
breshërash, stuhirash;

përzierje e tingujve
të së djeshmes, së sotmes, së nesërmes.
Thirrje e të gjitha kohëve:
«Bota është jotja».

Përmes saj ecën ti: profil i hequr,
sytë-copëra qielli, copëra nate.
Gjithnjë e dashruar,
gjithnjë e shqetësuar.
Ti ecën rrugëve të Atdheut,
udhëkryqeve të kohës.
Këtu del nga një këngë,
atje hyn në një shpresë,
më tej para një dashurie të re qëndron.

Rini,
kaltërsi e ndershme,
ëndërr e pavdekshme,
e tokës tënde.
Dashuria e saj të ushqen, të rrit kockat.
Dashuria jote tokën përtërin.
Mbi të ecën ti, — avalansh pune, djerse,
avalansh ritmesh, dritash...

Në trup të njomë, të ngrohtë,
në trupin tënd të butë, kërthi
mbështjell

gjithë ëndrrat e pafajshme të jetës;
me një këmishë mbështjell
himnin e ndershëm të së ardhmes.

Ti, gjak i bujshëm i komunizmit, i freskët,
derdhesh në trup të Atdheut,
në muskuj, në kocka,
në zemër, në tru,
në uzinë, kooperativë, në fermë,
ti, rini e pavdekshme e proletarëve,
hyn,
si në një fushë të gjerë
hyn dielli...

Para teje shkrin ngrica
e mejtimeve patriarkale, fanatike.
Nga qelli gris një copë re
dhe hidhua të fshijnë hundët skeptikët!
Dhe merri, të gjitha ç'kemi, merri:
dhe fitoret edhe humbjet tonë.
Ç'harruam pa të dhënë?
Përleshjet e ardhshme,
si tufë bubullimash, në duart e tua
merri, moj rini!
Dhe sulu mes kohërave.
Brohori e pamposhtur e jetës
mbush rrugët e kohërave.

Rini,
sykaltra,
truphedhura:
 «Bota éshtë jotja»!
Mes kësaj thirrjeje ecën ti,
dashuri e re e tokës sime,
 e popullit tim,
dashuri përjetësisht e re imja,
 Rini.

V A R G J E

Tokë e ashpër e gjyshërve,
e shenjtë si trupi tënd.
Anadolli i turqve
shkeli këtu në çdo vend.

Gjurmë-mesjetë e ngrirë,
plagë që dhemb.
Diku në shpirtin tim,
diku në shpirtin tënd.

Po është shekulli 20-të,
i 20-ti, s'do mend.
Dhe ku është Shqipëri,
është rini përnjëmend.

Ne kokë më kokë mbështesim
të dy në muzg.
Dashuria derdhi prej nesh
një hark triumfi.

Zvarrisen nën të dhe ecin
përjetësisht të mundur:
Bizanti i pabesë,
Anadolli i turqve.

Kanuni errësirë,
injoranca pis;
obskurantizmi i ngrirë,
xhelatët e dashurisë.

Tokë e ashpër e gjyshërve,
e shenjtë si trupi tënd.
Është shekulli 20-të,
i 20-ti, s'do mend.

Kokë më kokë mbështesim
të dy në muzg.
Dashuria derdhi prej nesh
një hark triumfi.

NË SHTËPI TË PRINDËRVE

zgjedhur e marrëve që këndoj
që këndoj e vëllimiq sësht
që këndoj e vëllimiq që këndoj
që këndoj e vëllimiq që këndoj

Në shtëpi të prindërve,
ku ishte babai, e nuk është më,
ku nëna e plakur, nuk është ajo
që ka qenë dikur;
ku pjergulla në kopsht,
konia e vogël,
fotografia e vjetër në mur, —
më shohin... diç duan të më thonë...
Dhe heshtin...

Në shtëpi të prindërve erdha sonte.

Nëna më priti si mik të largët,
më nxori liko e kafé.
Dhe më pyeti për fëmijët,
dhe më pyeti për gruan.

Pashë nënën të plakur, —
është e natyrshme, mendova.

Pashë pjergullën e tek unë
me vilet e rënda të rrushit,
kujtimet e pjekura u varën.

Është e natyrshme...

Konia nër këmbët e mia hunguronte
e me dhëmbë kapte, shkopsiste
gllomçat e lidhëseve.

Ashtu këpucët kërkonte të më zgjidhte
fëmijnia e njëhershme, që mbeti diku e vet-
me.

E kuptova: qen kam burrëuar...
Dhe se si më erdhi për veten.

S O N T E

Sonte,

Yjet, ndofta, s'i duhen kësaj nate, aq sa ti mua.
Dritat, ndofta, s'u duhen yjeve, aq sa ti mua.

Sonte,

erëza e trupit të kësaj mbrëmje më deh...
Dhe gjithë copërat e dashurive,
që i lashë diku nëpër rrugë të jetës
vijnë e ringjallen tek ti, —
si copërat e thyera të mermerit,
kur restaurojmë një statujë.

VDEKJA E GJYSHES

Ja, edhe gjyshja në arkëz,
kukull e vogël në kartëz.
Është... dhe prapë s'është e tëra,
sikur nuk është si përhera.
Gjithë karfica, gjilpëra,
kapur satenet në kokë,
lidhur këpuckat përposh,
shami e lule në gjoks.
Mbyllur kapakët e syve
(ç'diej u shuan brenda tyre?).

E sheh... dhe të duket heshtja
pe gjasme e pe gjasme vdekja.

Gjyshja e vogël, e bukur,
e pastër...

Në arkëz kukull.

Gjithë karfica, gjilpëra
qepur vite të tëra,
lidhur kujtime e malle,
dhembje, që duken si përrallë.

E sheh... dhe të duket heshtja
pe gjasme e pe gjasme vdekja.

O përfshirje, që dëgjohet që
në mënyrën e përgjithshme
Bijenka është vënë e fabrikantë që
dhe nuk ka marrë pëllim nga
Dhe nuk mundëse i marrëpërjetë se jeshur mire,
nuk mështë e komercantë,
me rëndësi së vërtetë e jeshurit
Bijenka është i rëndësishëm i këtij vjet
Kashkuq e Kukimiq që tani po është
një vjet që është

VARGJE PËR DRITAT

(*fragment*)

Gjeneratat vijnë njëra pas tjetrës,
shtyjnë njëra tjetrën
si dallgët e detit.
Gjeneratat kanë fytyrën,
biografinë e tyre,
 si njerëzit.

Gjeneratat, si erërat e qiellit,
njëra tjetrën pjellin
me gjëmime.

Obeliskë dëshmorësh,
shtylla tensioni të lartë, —
ja piramidat e kufijve të shenjtë
nga fillon gjenerata ime.

Këndeje turnet kapitës të natës
dhe këngët që shpesh i këndojmë
për të trembur gjumin;
shpatullat mbështjellë me një mushama,

që ia vemë zgavrave dhe presim ujin;
dhe vetë këto ditë — kështu siç janë,
gjysmë punëtore, gjysmë fshatare,
gjer në brez nën ujë të lara, —
të gjitha
do të vërshojnë, si vërshon lumi,
tuneleve e poemave,
që të vërtitin fletët e çelikta të turbinave,
të rrëzëllejnë qelizat e panumërtë
të ritmeve e të rimave.

Dhe ashtu si shndërrohen energjitetë,
në mizëri jonesh e elektronesh
do të shndërrohen të gjithë.

Do të kthehen
në rrëzëllime drithash.

Dhe ne, muzgu i mbrëmjes pa ardhur mirë,
nga salla e komandimit,
me një çelës të vetëm automatik,
Shenjëzat,
Kashtën e Kumtrit do të ndezim
 mbi Shqipërinë.

Nëpër këto linja tensioni të lartë,
që përhapen ngado si arteriet,
rryma elekrike — gjak i komunizmit
— gjatë këtij viti do të derdhet.

Janë rrederat e vjetra
avancimi i tij nuk është më i madh, i
fshëmimit e tij është shumë i madh,
në vëllgjë e avancit të vjetër që
fshëmimi i tij është
blloquar e vjetër.

Aj luftës modorëbërës, këtë vjet
dëshiron të bëj që dëshiron
një përfundim i modorëbërës.

Modorëbëri i vjetër që përfundoi
në një kohë të përshtatshme që nuk ka
një përfundim i kohës së tij, që
nuk ka një përfundim i kohës së tij.
Këtia vërtetë që vajzat e vjetra
dëshiron të bëj që dëshiron
një përfundim i kohës së tij, që
nuk ka një përfundim i kohës së tij.
Këtia vërtetë që vajzat e vjetra

METAMORFOZA E FIRMËS

Ja, borderoja e bardhë.

Ja, edhe emri tënd.

Firmëza aty ndanë.

Çdo gjë në vend? —

Në vend!

15 ditë zyrë,
apo në kabinet.

Dhe ke punuar mirë,
dhe ke punuar drejt.

Dhe të paguajnë hak.
Shpërblimi sipas punës.
Po mos harro aspak
metamorfozën e firmës.

Firma u bëka bukë,
firma u bëka mish.

Ajo bëhet këpucë,
ajo bëhet këmishë.

Dhe bukën e bën bujku
e këpucën punëtori,
Metamorfoza e bukur,
shiko se ku na nxori...

Ti thua: kjo është alfa?
Ti thua: kjo është beta?
Nga gjithë të vërtetat,
kjo qenka më e thjeshta?

Kurse prej meje prisje,
që tani vargu im, —
më dysh qiellin të priste,
sikur presin shalqinë?

Unë s'mundem t'i harroj
kufijtë as dhe një qime:
«mbaron liria jote,
ku nis liria ime».

Dhe niska andej jetë,
andejëza filloka,
nga ca alfa të thjeshta,
nga ca beta të vogla,

Dhe kjo qenka e bukur,
(pa leri dokrra e dokrra!), —
se bukën e bën bujku
dhe viçin e pjell lopa.

...Nga borderoja rrugën
e nis metamorfoza.

D R E J T O R I

Punëtori trokiti në derë.

— Hyrë! Dhe ai hyri.

— Shoku drejtor, me leje?

Jam i sëmurë...

Më therë lart mbi shpatull,
sa frymën ma mori...

Në duar përdredh shapkën,
I drojtur, si fajtor.

— Thashë të punoja dhe sot,
po qen kam i pamundur...
Drejtori shikon punëtorin
në kominoshe futur.

Drejtori sheh i menduar:

— Kështu... d.m.th... te mjeku,
gjer sot ti nuk paske shkuar...
E paske braktisur vet-veten.

Kur neve mjekojmë dhe lopët,
mjekojmë një kone, një pulë.
Gjersa je njeri, more shok,
ti mundet të jesh dhe sëmurë!

Gjersa je njeri... mund të dhemb,
ta zemë, shpatulla, brinja.
Dhe kur është sëmurë njeriu,
askush më nuk është mirë.

E ndjen edhe tornoja dhe hekuri,
E ndjen edhe toka dhe guri.
Kur është sëmurë njeriu,
e ndjen atë buka e gruri.

Të shkosh te mjeku, te shtëpia,
t'i biesh pas vetes e trupit.
Sekretare! Rrobat e mia
ku i kam, kominoshet e punës?

Ministri në më kërkoftë,
sekretari i partisë po të pyesë,
u thuaj: drejtori është poshtë,
në frezë...

REKUIZITA E BUROKRATIT

Dordoleci ka nevojë për një hu,
ka nevojë për zhele e rrecka.
Dhe mbi rrecka ngulur dy sy,
pastaj gojë, pastaj veshë të gënjeshtër.

Që ai shistaman të jetë,
ka nevojë dhe për fjalën — «dordolec».

Burokratit, që të jetë burokrat,
i duhet karrigia, telefoni.
I duhet Tomori me kartë,
dhe mellan Adriatiku e Joni.
Urdhëra e shkresa, ditë e natë,
të firmos nën rrotativa të qiellit vërtitës.
Burokratit i duhet, një servil i ngratë!
Si shpirti i gjithë rekuizitës.

Që servili të ulë peshkun e kurrizit
gjer në lumbalen e fundit.

Nëpër shkallare të tij burokратi të hipë,
si mbi pleh gjeli i parë i katundit. .
Që servili të përgjigjet gjithnjë: po!
Të mos thotë kurrë: jo!
Të thotë pérherë: ashtu është!
Dhe ne të na pyesë: si mund të jetë ndryshe?

Si mund të jetë ndryshe?
— Po këtu është klasa, Partia!
Si mund të jetë ndryshe?
— Po ne jemi qindra e mijëra!

Për trutë e burokratit nuk ka pjesë këmbimi.
Qindra e mijëra duar të klasës
bëjnë ç'montimin:
nga firmëza e vogël e gjer te prepotenca,
nga meskiniteti e gjer te arroganca!

Qindra e mijëra duar njéherësh,
nën rrotativa të qiellit vërtitës,
çmontojnë servilin e mjerë, —
shpirtin e gjithë rekuizitës.

DEDIKIM NË DITARIN E ANA FRANKUT

Ka gjëra të thjeshta në botë,
fare të thjeshta.

Psh fjala tokë,
apo një qiell vjeshte.

Ka gjëra të kuptueshme fare,
të pranueshme vetiu.

Tek ty vjen një dashuri e madhe,
një dashuri njeriu.

Dy sy fëmije pas një dritare.

Të kërkon... e nér xhamë dot nuk troket.

Kush është? — Bota e madhe.

Kush është? — Jeta vetë.

Ka një emër të thjeshtë gjer në dhimbje...

E merr nér duar, e kundron... e së largu
ndjen se si tek ty gjithë tragjeditë njerëzore
fundosen e kridhen...

Një emër njeriu — Ana Franku.

Nga dita në ditë,
 nga viti në vit. Varr që ecën
 udhëton, Dahau.
 Nëpër mjegulla të jetës.

Nga viti në vit,
 nga shekulli në shekull.
 njeriu i heshtur
 ndanë udhës dëgjon
 kërkëllimën e skeletëve,
 që brenda mban kjo fjalë:
 Dahau.

Njeriu s'harron.

DHE KJO KOHË . . .

Koka jote në duart e mia
prej burri.

Çfarë t'i shtoj dashurisë më shumë?
Çfarë t'u them Elenave, Laurave?
Mijëvjeçarëve të tyre të statujtë?

Koka jote në duart e mia prej burri...
Kohë e ashpër! E ashpër...

I përgjakur
Syve të tua Vietnami hyri,
midis buzëve të mia varrosën Ana Frankun.

Koka jote e vogël, e dashur,
në dy duar nervoze prej burri...

.....
Dhe kjo kohë e ashpër! E ashpër!
Që s'e mohojmë dot kurrë,
që s'na mohon dot kurrë.

NE OROSH

Këtu është Oroshi, këtu...
Kërcnim i kanunit dikur.
Kryq e bajrak.
Errësirë. Gjak.
Këtu dashuritë e mia shiteshin, bliheshin
në djepe, në bark.

Dashuritë e mia fare pak qancell.
Dashuritë e mia fare pak diell.
I fyenin.
I fyenin.
I fyenin.
Cilin tjetër, veç dashurive, —
të pafajshme,
të pambrojtura, —
ashtu mund të fyenin?

Këtu është Oroshi, këtu...
Bulurim i bajrakut dikur.
Vetmi. Trishtim.
Humbëtirë?
— Më keq, harrim!

Këtu toka kishte uri njësoj si njeriu.
Si njeriu zhveshur në shqotë, në breshër.
Shiu e ngrica i hynin në eshtër.
Toka mbi supe hidhte trastën e lypsit.
Ekte me ditë, me netë. Ekte.

Nga kulla në kullë lypte
një babune misër.

E misër kush jepte?

Misër kush kishte...

Jo hija e maleve, —
s'e linte misrin të bëhej hija
e sarajeve!

Kur lindnin Romeo këtu e Xhuljeta lindnin.
Që as e dinin se ç'ishin Romeot, Xhuljetat.
Që veten e tyre me dorë e fshihnin,
si hirin në vatër. Pluhurin e hidhnin
me grushte në ajër:

Mbi gurë,
mbi shkëmb,
mbi kreshta.

Dhe lindnin të tjerë Romeo, të tjerë Xhuljeta.

Shekspirë nuk kishte. (Bah, Shekspiri këtu nga të
vinte?!)

Prapa një suke të kohës
ia ngrinin tinzare pritën.

Si Bankos Makbethi? Ëh, si Banko Makbethi...
Këtu ishte Oroshi, këtu... i përgjakuri
me gjakun e vetë Shekspirit, që dot këtu s'erdhi.

Se drama luhej njëloj, kur koha rrëkellehej tëposhtë.
Dhe skena e gjallë ishte Oroshi:
... sarajet i donin gratë të hijshme,
nuset të bukurë.

Një lulebore diku po të çelte,
duart e tyre shtriheshin për ta këputur.

Syri i femrës së tyre,
si syri i diellit duhej të ishte.

Dhe rrezet që rridhnin krojeve bjeshkës,
duhej të rekëtinin nëpër sy, nëpër buzë,
nëpër kérce e kocka të femrës.

Ata i peshonin gratë me flori e me plumbë.
Se do të bëheshin nënët e tyre,
do t'u pillnin pëllumbë.

Pëllumbë që në trup s'do të kishin gjak,
si ti e si unë.

Po vezullitje verbonjëse bore,
gjak të bardhë, të kaltër kapedanësh
e princësh më shumë.

Ndryshe duhej të ishte gjiri që ata i mëndte.
Ndryshe djepi që i përkundte.
Ata duhej të ishin drita aguese e vendit.
Dhe në qoftë se një diell tjetër lindte diku,
ndanë një vatre të varfër,
në një djep thanë;
në qoftë se një mec malësori lindte diku,
që verbonte dritën e tyre... Ah, po këtu
ishte Oroshi, këtu!

Jo hija e maleve, — mbi malet,
si hija e një shpendi ogurzi — binte
hija e sarajeve.

Kur toka lindte çdo ditë bukuritë e saj,
toka pillte çdo ditë dashuritë.
Mund të mos bëhej misri i verdhë nën sarajë,
po bëheshin dashuritë.

Ato hynin në pranverë e pranvera
gjelbëronte prej tyre;

ato hynin në vjeshtë e zbehej vetë vjeshta.
Pinin gjirin e lokeve, hanin djath e shëllirë.
Dhe papritur, papandehur një ditë,
ballë për ballë sarajeve ngriheshin...

dashuritë!

Mund të ishte ajo Xhuljeta?
Drana e Pashka mund të ishte? —

Sidoqoftë ishte Jeta!

Jeta e gjetheve dhe e krojeve,
e luleve të mollës e të zgjojeve,
jeta e heshtjes së gurëve,
e mendimit të pyjeve.

Jeta e valleve të yjeve,
e qiejve në muzgje gëzimi;
jeta e kraheve të fluturave,
jeta e bukës. E blegërimit
të bardhë të një deleje që thërret pranverat e maleve
Ishte jeta e njerëzve të tokës...

... dhe vdekja e sarajeve!

Sarajet nxinin.

Sarajet sterronin.

Jo gjak, — në trutë e tyre
ditë e natë
vrerë e qelb kullonin.

Si mund të ishin malet më trima nga ata?
Si mund të ishin malet më të mençëm nga ata?
Si mund të ishin malet më të pashëm nga ata?

Malet e veshur me lëkurë dhie
e kërrabën nën sqetull, —
në dy buzë imcake dashurie,
si mund të mbanin vetë jetën?

Në vrerin e tyre sarajet ndillnin vdekjen.
Helmonin Xhuljetën...
Dhe «kroi i varzës»¹⁾ i helmuar
rridhte gjithë jetën.

«Kroi i varzës» fliste me zërat nën dhé:
nuk është për ne dashuria,

1) Krua mbi Orosh.

as kënga e luleve,
as vallja e rrezeve të diellit, —
nuk është për ne...

Rënkonin ujërat e bjeshkëve
e me zëra njeriu flisnin:
ulen kurrizin,
ulen kurrizin!
Për ne është pylli e shpati,
është kosa e sëpata,
për ne është balta...

Sarajet janë të larta...

Mallkuar qofshin sarajet!
Po si i bëhet,
si ushqehet kjo tokë me një bukuri të tillë?
Mbytur qofshin sarajet në helmin tonë!
As kryqi, as ligji dot mos i shpëtoftë.
Po si i bëhet,
si ushqehet kjo tokë me një dashuri të tillë?

Ulërima e tij ngrinte në këmbë
dhe jetëni, dhë vdekjen.

Sarajet heshtnin. S'bëzanin.

Nuk luanin as syrin, as gishtin.

Zgjatnin nën dorë 20 napolona flori,
një nagantë fildishi... .

Dhe Romeo e vrisnin.

Këtu s'kishte Shekspirë.

Shekspiri kërkonte të paktën mesjetën.

Po si të jetonte në qull-errësirën
e Oroshit të vjetër

ku të vrisnin natën e të qanin ditën??!

Ku vrisnin dhe bukën, ku vrisnin dhe kripën.

Po ku dashuria jetonte gjithë jetën.

Se tani... unë do t'jua them të vërtetën:

i shihni atje në majë të pishës

me borë, dy zogj të vegjël?

Në degë të ngricës...

Gushë më gushë cicërijnë.

Sho-shoqit i japid ngrohtësinë e trupit.

Me trupin e tyre ushqejnë dashurinë

dhe e ngjallin jetën.. .

Dy zogj të vegjël

të Oroshit të vjetër.

Orosh, dhjetor 1975

TË DIEL NË MËNGJES

*dashuri komitash shqiptarë —
motiv populor:*

Të diel në mëngjes
të ngrihesh, të vish.
Dielli ndofta s'del,
në udhë ndofta nge!, —
të që në mëngjes
të ngrihesh, të vish.

Fushës të mos vish.

Sa ka fusha bar,
jeshilojnë nizamë.

Në një pikë loti,
si të të mbaj ty:
trupin në zinxhirë,
kokën në syngji.

Të diel në mëngjes
të ngrihesh, të vish.

Dita ndofta s'vjen,
ndofta diku ngel.
Ti që në mëngjes
të mëngosh, të vish.

Malit të mos vish.

Gurë e shkëmbinj
mali nxin asqerë.

Në një pikë loti,
si lëkundesh ti:
trupin në zinxhirë,
kokën në syngji...

Të diel në mëngjes
të vish e të vish.

MARATONA E DRITAVE

Ju rendët nér shekuj
gjithnjë drejt lirisë.
Një pishë të ndezur
në dorë për dritë.

Pastaj Shkopetin,
Bisticën e ndezët.
Maratona e dritave, —
maratona e jetës.

Sot zjarret e Fierzës
në duar i mbani.
Po nesër, Komani?

Tej shkrepi Komani...

BISEDË MIDIS SHOKËSH POETË

Kur ti më thua se e do Atdheun
shumë...

Sepse atdheu, — thua ti, —
është toka e qielli,
drita dhe uji,
buka përmbi tryezë,
rakia e mishi
dhe kënga që këndojmë
ti dhe unë,

Unë them ke të drejtë.

Ah, harrova diçka:
atë që bën bukën,
atë që na rrit qengjin

Njerëzit...
Njerëzit...

MË THIRRE?

Më thirre? Erdha.

Se erërat pas erërave shkojnë,
dallgët pas dallgëve.

Më thirre? Erdha.

Njëri-tjetrit i dalim përpara,
si dy re nëpër shi e shtrëngatë
me gjëmime takohen
nëpër qiejt e lartë.
takohemi,

KUR VIJA TEK TY....

Në fushën e mbrëmjes unë lozja me erën
dhe era me mua e me veten lozte.

Dhe vija tek ty e shkelja përherë
me hapin e parë, që mbi tokë hedh foshnja.

Dhe mbaja në buzë trëndafila të bardhë
këputur mes valëve të detit të gjerë.

Unë isha kambana që diku në muzgje
kumbonte në qiell vetiu prej ere.

VLORA E FËMIJNISË

Krrak-krrak-krrak lejlekët
nëpër minaretë.

Ditën e Shëngjergjit,
një verore e kuqe,
në sqep dallëndyshesh.

«Allah» — muezinët.
«Zoti Krisht» — priftërinjtë.
Në karrocë kalushi

i madhi i bashkisë.

Ndonjë bezë krimbur
e sheh syri rrallë.
Bytyn agallarë.
Beter agallarë.

Mbi qafë;të trashë
nga një kokë kërrici.
Si brenda, si jashtë,
ndërtuar prej hiçi.

Qielli malarik, shkrehur, veremosur.
Mesjeta e vdekur
dhe e pavarrosur.

Sokak i kovaçëve,
samarxhijtë në tjetrin.
Mesjeta si shtërp
në sëqepë lejlekësh.

Bakejtë të mehur
brenda fjalës: «krizë».
Lart e poshtë kandarët
i luajnë me gisht.

Ditët mund t'i heqësh,
si rruaza tespish.
Brenda tyre Bambu
lot edhe Tomiksi.¹⁾

1) Emra artistësh filmi.

Fëmijnia ime
lodër guacash deti.
Zogu s'e do Vlorën,
Vlora s'e do mbretin.

Konsullata e huaj,
burgu përkarshi.
Burra zemërdielli,
kredhur në qeli.

Në gushë t'ogiçit,
tundet xhufk'e leshit.
Tej surrat i Duçes
prej mjegullash deti.

Po kur linda unë,
mbi rrogozë fshese,
ishte pak a shumë
Vlora e 20-tës.

Dhe në djepe druri
Mamaga¹⁾ s'më koti

(1) Gjyshja ime

Më tundi Ziguri¹⁾
me britma mbi Kotë.

Krrak-krrak-krrak — lejlekët
nëpër minaretë.
Fëmijnia ime, —
lodër guacash deti.

Vlora e fëmijnisë
kredhur në livadhe, —
çelur gjithandej nergjize të bardhë.

1) Zigur Lelua — trim i Luftës së 20-tës.

DUKE U LARGUAR PREJ VLORE

Po nisem pa u përshëndetur me detin.

Vetëm kësaj radhe
nuk dola në brigjet e fëmijnisë,
të përfalesha me pulëbardhat e mia...
Nuk e durokam dot më
këputjen e trupit prej trupit.

Më duhet të nisem?
Pa kthyer kryet pas!

Sulem kudo më thërret zëri i jetës.

Vetëm nëpër të plasurat e buzëve
më djeg jodi e kripa e detit.

NE ZVÉRNEC

Po ty këtu të gjithë të duam shumë:
dhe kalldrëmet e fshatit,
dhe rigoni i pjekur. Dhe bari.
Mendim i ullinjve,
pulëbardhat e qiellit,
dhe hardhucat nëpër varret e bardhë.

Edhe unë...

Po si s'e kuption, që të duam kaq shumë!
Edhe fluturat e valëve
liqenit, me krahë fërfërítës të bardhë.
Heshtja e pelikanëve.
Peshkatarët nëpër lundra të vogla, të drunjta.
Dhe Zvérneci që humb
në një këngë drite gjinkallash.

Edhe unë...

HUMBA NË SHOQËRI ME DETIN

Humba në shoqëri me detin.
Ikë deti — ec unë pas tij.
Ikë unë — hajde deti pas meje.
Dhe më fliste deti fjalë stërkalash,
fjalë ere, shpirt deti në muzg.
Unë i flisja për bukë.
Dhe më thoshte deti për ca qiej
të mëdhenj e të ulët,
që gati puqeshin me valët e tij,
ku yjet fërgëllonin si flutura...
Unë i thosha: — S'ka asgjë të keqe
që romantikat të jenë të bukura;
s'ka asgjë të keqe që të jenë tokësore,
s'ka asgjë të keqe që ëndrrat
të jenë fëmijnore.
Po unë jam — unë.
Unë jam edhe gurë edhe diell,
edhe djersë edhe gjak.
Unë jam një fjalë e përgjakur kundër padrejtësisë,
një zemër njeriu në flakë.
Deti më fliste për ca diej të mëdhenj, të përskuqur,

që shuheshin gjireve të tij,
si sy qiklopi në natën që binte.
Unë i thosha: — Po mirë, xhanëm,
le të rrokullisen nëpër trupin tim
diejt e flaktë të perëndimeve të tua;
le të ngrihen nëpër gjithë qenien time
zërat e gjeratoreve të tua;
erërat le të fryjnë, dallgët le të përplasen
brinjëve-brigjeve të shpresa të mia.
Po unë jam njeri. Dhe si njeri
më duhet edhe bukë edhe mish,
dhe një këngë dhe një këmishë,
më duhet dhe libër edhe këpucë.
Dhe të gjitha i marrkam me luftë.
Luftë kundër feudalit e borgjezit,
kundër vocërrakut të tyre, mikroborgjezit;
kundër servilit e prepotentit,
që më shurdhoi timpanin e veshit: Unë! Unë! Unë!
Ti... Tii... Tiii...
A do edhe ti bukë e mish?
A do spinaq e oriz?
Ahere, pa eja këtu e mëngët përvish!
Nuk më merr vesh?
Po ç'ka këtu për të mos marrë vesh?!

Kjo është fare e thjeshtë:
luaj duar e këmbë — derdh djersë!
Dhe brenda një pike djerse
ndërtó romántikat e jetës.

Do ti? Brenda një pike djerse
krijo universet!
Ai peperun nockë e turrinj...
Ashtu? Ti vërtet që s'marrke vesh!
Dhe ahere unë po nis nga ty, — unë asgjësoj
kozmosin e prepotentit
dhe krijoj qenien e vogël, tokësore,
punëtor e të ndershëma — njeriun e thjeshtë.
Humba në shqëri me detin.
Ikë deti — ec unë pas tij.
Ikë unë — hajdë deti pas meje.

“Më iku më iku” përdhunon...
Ridet, rinditet, rinditet...
Ridet, rinditet, rinditet...
Ridet, rinditet, rinditet...

KY SHEKULLI IM. . .

... Ky shekulli im Prometé,
që zjarrin e shenjtë të revolucioneve,
si në vatra të varférish,
ndez në zemrat e njerëzve mbi dhé.

... Ky varr madhështor i skllavërive.
Me pluhurin e kockave të tyre,
plehëron pranverat e jetës.
Në çdo rrënje lirie
hedh nga një grusht hiri prej tyre.

Ky bujk i paçlodhur i historisë.

... që s'e ka të lehtë shumë.
Që porsi prindi me shumë fëmijë,
kokë për kokë, —
kontinentet, popujt i zgjon nëpër gjumë.

... Ky shekulli im, i sfilituri.
Në pagjumësinë e tij,
sheh gypat e krematoriumeve,
që i tymojnë nëpër trup.

Me gjithë peshën e tragjedive të tij,
rëndoi mbi vet shekullin XX,
e bëri palmuç.

... ky shekull i popujve-Prometé.

Që me nofulla të hekurta

çdo çast përtyp e bluan

eshtra perëndish e altaresh.

... ky shekulli im njerëzor,

që s'e ka të lehtë shumë.

Që porsi prindi me shumë fëmije,

kokë për kokë, —

kontinentet, popujt i zgjon nëpër gjumë.

31 DHJETOR 1976

Njerëzit me lodra-dhurata fëmijësh nër duar.
Rruga zien.
Lepurushi llapush paska blerë ajo grua,
ky burrë — qenushin e verdhë.

Ai atje — ariun e murmë.
Kërcen? Kërcen! Vetëm kurdise.
Unë u ndala në muzg,
mendova: Bota vërtitet...

Vërtiten meridianë e paralele.
Në luftë janë klasat e shtetet.
Dhe dita e nesërme që vjen
prapë do kërkojë punë, bukë, përleshje.

Toka do kërkojë njerinë
e gruri djersën.

Ti do kérkosh prapë dashuri në
e unë vjershën.

Nesër njerëzit do kérkojnë të jenë më të mirë,
dhe më të ndershëm — s'do mend!

Në qoftë se botës i është shtrembëuar kockë e brinjë,
do t'ia heqin, do t'ia drejtojnë
e do t'ia venë në vend.

Ndërsa tani në turma ngjeshur
shkojnë me lodra fëmijësh nér duar.
Në dorën time, me cigaren e ndezur,
ta zemë, zemra ime paska qëndruar.

Kalush i bardhë, që të vijë tek ty shpejt,
në pëllëmbë të dorës trokon e hidhet?

Hidhet! Vetëm kurdise.

Në luftë janë klasat e shtetet.
Bota? Vërtitet!

NË KAFE TIRANA

24 prilli. Kafé Tirana.

Një dallëndyshe hyn brenda, gabimisht?
Rreh krähët nér mure, përpëlitet në xhamë,
do që të dal jashtë, sigurisht.

Shoh shpendin e vogël, ligjërimet blu,—
dhe veten kujtoj
dhe ty...

Dhe gjithë dritaret e kraharorit tim
i hapa tejendanë njëherësh.
Kanatat e tyre përplasen në erë,
në qiell të lirë.

Në qoftë se tek unë gabimisht ke hyrë, —
sulmo hapësirat me diej e yje!

Pa unë ngado që jam, kudo që shkoj,
jam ajo copë qielli që ty të mban,
ajo copë qielli ku tani
ti fluturon.

M B R Ě M Ē

Katnida u svj e jasnyj na

Mbrämë, kur kthehesha në shtëpi,
nga dritarja e katit të parë

pashë këtë skenë:
mbi shpatullat e një burri — një fëmijë.
Hidhej burri, hidhej fëmija.
Rendte burri, thërriste fëmija: Hajt! Hajt! Hajt!
Brinjët e të atit qëllonte me këmbë.

Ky vinte vërdallë nëpër dhomë e thërriste
me zërin e rëndë.

Po dhoma e vogël ishte... Hajt! Hajt! Hajt!

Burri u ndal në mesin e saj,
gulçonte, me zor merrte frymë.

I vogli u ngrit e duart zgjati drejt dritës.

I ati e afroi.

Po sa desh ta kapte, e largoi.

Duart e foshnjes, si krahë fluture përpëliteshin

e prapë shkonin drejt dritës.

Dhe kështu një... dy... tri herë ...

Qeshte fëmija.

Qeshte burri.

E duke qeshur ashtu i vogli u përkul
mbi prind të vet, aq afër,
sa fytyrat e tyre u shkrinë.

Errësirë në rrugë.

As hënë e as yje.

Po mua m'u kujtuan brezat,
gjeneratat,

që njëra tjetrën mbajnë mbi shpatulla,
e njëra tjetrën mësojnë dritat t'i kapin me duar.

DREJT QINDRA SHEKUJSH SHKOJMË...

... qindra shekujsh shkojmë
... qindra shekujsh shkojmë
... qindra shekujsh shkojmë

... qindra shekujsh shkojmë

Ne ishim një skuadër partizane. Papritur i pari u ndal. Qëndruam të gjithë: një grua e vrarë rënë në mesin e udhës. Në gjirin e saj foshnja pinte ende qumëشت.

... dhe shtangëm në muzgun e ngrirë,

Sytë e shqyer
foshnjën e habitur shihnin, përpinin...

Ngrica e mbrëmjes shpërfytyroi të parët.
Ne asgjë më s'shikonim.

Vnim prej qindra shekujsh, drejt qindra shekujsh shkonim:

Përkuli gjurin i pari,
Shajakun nguli mbi tokë.
Dorën drejt foshnjes ndëri, —
s'e preku dot.

Dora e varur
në zbrazëtirën e mbrëmjes mbeti.

Dhe asnje fjälë.
Dhe asgjë tjetër.
Kumbonte vetëm
hapi i nazistik, që prapë diku ecte.

Çizmja esese që ndizte
hakmarrjen tonë të tmerrshme.

Gjithë kokallat e varreve
luanin brenda e zgjoheshin
nëpër atë vdekje...

Pesë gishterinj të vegjël,
lyer në qumësht e gjak,
si pesë qënie të gjalla
lëvizën edhe u hapën.

Natën...

Foshnja nënën e kap,
jeta kërkon që të pijë, —
të rrojë

mbi vdekjen!

Heshtje.

Dhe asnjë fjalë.

Pastaj copë-copë
nëpër muzg të ftohtë,
këputen monologët:

— Foshnje e pafajshme, e mitur.
Jo nér shpërgenjtë e leshtë, —
po në këto ditë,
si nér flamurët tanë mbështjellë e lidhur.

Një e nga një në sy
foshnja na sheh radhë.

Midis syve tanë, —
nëna e vrarë...

Nëna...

Që me lavdinë tragjike të Sulit,
me këngën tragjike të Çikës,
si me dy gjalmet e shamisë së zesë,
ballin e saj e lidhi përjetë.

Midis syve tanë, —

diell i thyer mbi tokë,
nëna e vrarë...

Kjo vdekje është më e madhja
nga gjithë vdekjet e tjera.
As arkivoli i natës
nuk e nxë dot të tërën.

Një e nga një në sy
foshnjën shohim radhë.

E sytë...

Çfarë mund të thonë
sytë tanë?

Përbrenda tyre mbiu,
degëz e njomë hardhie,
dorë e këtij çilimiu.

Foshnja me katër gjymtyrë
këmbadorazi hiqet...
Gjurmë pëllëmbësh e putrash
përzihen prapa e ngelin...

Kraharori i nënës i gjerë,
shkon diku shkrihet me qiellin.

Thua gjithë horizontet,
si toka jonë e perflakur,
andej burojnë e andej përhapen.

Natën...

Heshtën gjithë frontet e largët:

dhe Stalingradi,
dhe ti Drashovicë.

Me partizanët kokë më kokë,
Qafë e Pëllumbit, Tenda e Qypit,
u mblodhën gjithë rrëth fëmijës.
Heshtin me ne frontet e largët.

Dhe s'kemi kohë të heshtim.

Plagët
e shokëve mbajmë;

mbajmë erë sulmesh
dhe drejt përleshjeve ecim. . .

Lamë foshnjet, që te kjo foshnje të vijmë.
Lamë plugjet, çekanet e penat,
që dorën tonë presin,
si gjethin e prillit
e pret trung i zhveshur;
lamë nënrat,
nëpër bokërrimë varret e shokëve mbollëm
(se me gjak mbi këtë tokë mbillet dielli) —
që te kjo nënë e të gjithëve të vijmë.

Në kurmin fërtelë të botës
u dhjamka kapitalisti. . .

Nën lëkurë të tij
mbijnë skuadrat esese.

Para e prapa tyre, —
ky krim i tmerrshëm.

Foshnja pyet me sy:
po çfarë ka ndodhur kështu?

Po çfarë ka ndodhur me nënën,
që hesht e nuk bën zë?
Gjirin përse s'e ka ngritur
pakëz, ashtu si gjithnjë?

Sytë zmadhohen, zmadhohen...
Foshnja kërkon e habitur.

Jemi ata pesë gishterinj,
që kapin sisën e ndukin;
jemi ato dy buzë,
që po thëthijnë e mëndin
gjirin e ftohtë të nënës.

Fushnja mes katër udhëve,
sheh nëpër dritë të hënës,
malet rrëqethen e shkunden.

Dënesje në errësirë.
Nëpër gulçime t'urrejtjes
dikush po qan.

Armën lëshoi mbi tokë,
foshnjes i vajti pranë.
Preku fustanin e çjerrë,
preku çorapen e leshtë.
Dhe nuk guxoi ta ngrerë.

Eshtë Salamina?
Eshtë Saragoza?
Rreth kësaj nëne të vrarë,
pranë kësaj foshnje të gjallë,
Guernika,
Borova prapë u ringjallë?

Zemra fisnike luftëtarësh,
që kur i thirri liria,
u çuan edhe prej varresh.
E që s'u shkoi nér mend,
se n'udhëkryqet ku prét,
si me sëpatë historia
më dysh shekullin XX,—
në këto male të mia
këtë krim të takonin.

Në këto male të mia,
ku nëpër qiej të shekujve,
porsi dy degë vetëtime,
fekste edhe mjerimi,
shpërthente dhe trimëria...

As do t'u shkonte nér mënd
në gji të vdekur të nënës,

një kalama të shikonin
gjithë universin ta mëndë.
Vnim prej qindra shekujsh,
drejt qindra shekujsh shkonim.

Gjirin e nënës prapë
dorë e vogël mbështollë,
si mbështjell rrezja e diellit
gjysmën e globit.

Në atë dorë të mitur
lyer në qumësh e gjak,
lëmshi i dheut
u ndal.

Heshtje.

Më asnjë fjalë. Asnjë dënesje.
Dëgjohet vetëm çizmja e krimit,
thundra që ngjeshet
mbi shpirt popujsh,
mbi kocka shtetesh.

Po ja,
si në pëllëmbën time të dorës,

bish' e goditur për vdekjë jep shpirt,
nga lumi Jance,
gjer të lumi i Vlorës.

Ç'ka Salamina e vjetër?
Ç'do Salamina më tepër?
Mbi ballin e çdo lirie,
gjethë të njomë dafine,
vumë këtë dorë fëmije.

Nër ato shtigje e udhë,
që dorë e foshnjes ka bërë, —
drejt horizontesh të gjerë
nisuni popuj të tërë!
Këtu në Kunjovë u përgjakën të gjithë.

Shekujt e shkuar,
të tjerët që vijnë, —
fytyrën e kësaj fëmije po marrin.

Fushnja dhe nëna, si dy agime,
njëra-tjetërës përpara i dalin.

E zgjati dorën i pari,
foshnjën hodhi në krahë.
Rruga çon përpara? —
Përpara, pra!

Vijmë prej qindra shekujsh,
drejt qindra shekujsh shkojmë.

Vetë zbathur e zhveshur,
këmbët e duart e saj do t'i ngrohim
me frymën tonë përgjithnjë.
Kishim harruar të buzëqeshnim?
Nëpër veten tonë do të kërkojmë,
do të shkulim një buzëqeshje për të.

Përpara, pra!
Kraharori ynë tribunë.
Gjyqtar i tmerrshëm kjo foshnje...

Ju, që me gisht kandari,
lirinë shitni e bukën,
peshoni diellin e majit,
peshoni qeshjen e buzës, —
sa do ta shitni tanë,
fare pa asnje reklamë,

pikën e qumështit të nënës,
pikën e gjakut të saj?

Ne i mbërthejmë përgjithnjë
në arkivolin gjigand,
dhe perënditë e mykura,
edhe padronët bastardë.

Dhe me foshnjën hopa,
tek shkelim botës së vjetër,
zemrës së saj i biem,
kambanë funebre.

Përpara, pra!

Se kjo toka jonë,
gjithnjë dashuritë e përgjakura,
mbjellur trupit të saj,
porsi zambakët,

që mbjellim me dorë;
këto agime lirie,
me amanete dëshmorësh,
si gjethe prilli të gjelbra;
barin e njomë e ëndrrat,
lulet që çelin e shpresat;
kjo toka jote dhe imja, —

Lavdinë e saj,
Pavdekësinë e saj, —
si gjiri shenjtë i nënës
i kthen në qumësh të bardhë.

Qumësh e gjak i lirive.
Foshnjen me të e mëkon.

Në kraharor tonë fëmija
lot e na vë midis buzëve
gishtërinjtë e imtë të tija.

Edhe përkulet, përkulet,
që partizanin të puthë.

Ballet e tyre u puqën.

Ylli i partizanit,
i proletarëve të kuq,
dogji në ballë të fëmijës.

Gjurm' zjarresh revolucioni,
Ylli Partisë pérjetësisht
u ndez atje e ndriçon.
Arbund është këtij mënyrë që

Ç'ka Salamina e vjetër?
Ç'do Guernika më tepër?
Mbi ballin e çdo lirie,
gjethë të njomë dafine,
vumë këtë dorë fëmije.

Vijmë prej qindra shekujsh,
drejt qindra shekujsh shkojmë.

PASQYRA E LËNDËS

Shqipëria	3
1. NË VARREZAT E DËSHMORËVE NË VLORE	5
5 Maj	7
Teli Ndini	8
Xheladin Beqiri	9
Kastriot Muço	10
Shyqyri Alimerko	11
Fejzo Gjomemaj	12
Mitad Dauti	13
Lefter Sallata	15
Pirro Palla	17
Fiqiri Muka	18
Jani Mone	19
Fadil Dauti	20
Zaho Koka	21
Hysen Çinua	22
Sulo Didi	23
Dadan Dajlani	25
Ikja e fëmijnisë	26
II. HIMN JETËS	29
Himn jetës	31
Poezisë	33
Rinisë	36
Vargje	41
Në shtëpi të prindërve	43

Sonte	45
Vdekja e gjyshes	46
Vargje për dritat	48
Metamorfoza e firmës	51
Drejtori	54
Rekuizita e burokratit	56
Dedikim në ditarin e Ana Frankut	58
Dahau	59
Dhe kjo kohë	60
Në Orosht	61
Të djelë në mëngjes	69
Maratona e dritave	71
Bisedë midis shokësh poetë	72
Më thirre?	73
Kur viaj tek ty	74
Vlora e fëmijnisë	75
Duke u larguar prej Vlore	79
Në Zvérnec	80
Humba në shoqëri me detin	81

Ky shekulli im	84
31 dhjetor 1976	86
Në kafe Tirana	88
Mbrëmë	89
Drejt qindra shekujsh shkojmë	91